



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **40**

Prishtinë, më 24.3.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Lulzim Zeneli, Zulfi Merxha, Naim Maloku, Myrvete Pantina, Heset Cakolli, Elhëme Hetemi, Ali Lajçi, Berat Luzha, Zef Morina.

Munguan : Selvie Halimi, Dragiša Mirić

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Komisioni për Buxhet (Kosara Nikoliq-nënkryetare, Riza Smaka, Safete Hadërgjonaj, Hajdin Abazi, Myrvete Pantina, Myfera Shinik), zyrtarët nga MMPH- Ministri Mahir Yagcilar, Naser Balaj dhe këshilltarja e Ministrisë, nga OSCE Blerim Vela dhe Maria Berishaj si dhe zyrtari nga MBPZHR-Shefki Zeqiri.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku

Mbledhjen e kryesoi : Lulzim Zeneli, kryetar i komisionit.

TAKIMI I PËRBASHKËT ME KOMISIONIN PËR BUXHET

Lulzim Zeneli përshëndeti anëtarët e dy komisioneve dhe arsyetoi caktimin e këtij takimi sipas kërkesës së komisionit për buxhet, për të bërë përpjekje të përbashkëta rreth tejkalimit të problemeve financiare të cilat do të shkakttoheshin, poçes shkojnë më tutje amendamentet e komisionit funksional. Ai kërkoi sugjerime të mëtejme si të tejkalohet kjo çështje duke ja dhënë fjalën së pari zyrtarit nga MBPZHR.

Shefki Zeqiri tha se MBPZHR me politikën e saja mbështet krijimin e agjencisë së pagesave për Bujqësi për shkak se bëhet fjalë për një sektor tepër të dëmtuar. Njëherit kjo ka qenë përpjekja e zyrës për integritet evropian në funksion të përparimit të bujqësisë sepse donatorët e ndryshëm kërkojnë adresimin e financave për bujqësi në vendin e caktuar. Ministria e bujqësisë konsideron se duhet të krijohet bërthama fillestare për këtë problematikë për çka nuk do të krijohej kosto e lartë, ata kanë llogaritë shumë prej 200.000 euro për tri vitet e para (përfitimet për fermerët do të ishin shumë të larta), ose së paku të veçohet me një nënkod të veçantë të cilin Ligji për financa publike nuk e ndalon shprehimisht.

Hajdin Abazi ishte i pajtimit që të bëhet çdo gjë në favor të zhvillimit të bujqësisë por kjo të rregullohet me ligj, së pari problemi i punësimit të njerëzve dhe së dyti si të themelohet një linjë e veçantë për këtë qëllim (nënkodi i veçantë) për të mos pasur probleme më tutje, dmth fjala është se duhet të harmonizohen gjërat me ligjin për financa publike.

Shefki Zeqiri reagoi dhe sqaroi se në vendet e rajonit ka kaluar kohë deri në konsolidimin e këtyre agjencive (5 vite së paku), ndaj edhe me ndryshimin e rrethanave do të ndryshojnë edhe gjërat.

Riza Smaka u pajtua se për bujqësi duhet bërë çdo gjë, por pengesat formale juridike në amendamentet e propozuara nuk lejojnë të gabohet në këtë drejtim. Vetë emri i agjencisë është në kontradikcion sepse në kuadër të një Ministrie nuk mund të ketë edhe një person juridik, ndaj mund të mos themelohet agjencia por një shërbim i veçantë që do të kryente këto punë në mënyrë legale përmes krijimit të një nënkodi.

Elheme Hetemi, Safete Hadergjonaj dhe Myrvete Pantina kishin mospajtime rreth krijimit të agjencisë në fjalë, sepse znj. Safete thoshte se nuk mund të krijohet institucion i pavarur sipas ligjit për financa sepse krijohet fond i veçantë, dmth së pari duhet të ndryshohet ligji e pastaj të themelohet fondi, poashtu emri i agjencisë duhet të tregoi se për çka dedikohet (për zhvillimin rural) ndërsa zj. Elheme ishte e mendimit se agjencia krijohet vetëm sa i përket donacioneve nga jashtë që arsyetohen me projekte pa gjeneruar tjera mjete. Myrvete Pantina mbrojti amendamentet e komisionit funksional duke propozuar mundësinë e krijimit të një nënkodi në suaza ligjore.

Lulzim Zeneli gjithashtu mendoj se agjencia do të funksiononte në kuadër të MB, mirëpo znj. Safete pyeti : çka do të bëjë Departamenti për zhvillim rural (duke aluduar në pasivitet të departamentit).

Shumica e anëtarëve të komisionit për buxhet insistuan të hiqet së pari dualiteti i krijuar (Hajdin Abazi), ndaj së pari duhet të kthehen propozimet (amendamentet) në ministrinë e bujqësisë të cilët do të propozojnë si do të themelohet ky agjenci apo ndonjë organ tjetër, të përcaktohet statusi origjinal, të jetë më i qartë duke sqaruar mekanizmin e veçantë dhe të plotësoi kushtet ligjore, ngase me vet faktin se paraqet agjenci të pavarur ajo ka implikime buxhetore (Kosara Nikoliq). Si rrugëdalje u propozua krijimi i një nënkodi të veçantë për shkak të moskthimit të donacioneve dhe mos të pranohen kuadro të reja por të shfrytëzohen ato ekzistuese.

Para se të përfundoi takimi **Lulzim Zeneli** hapi diskutimin edhe rreth krijimit të agjencisë për rrezatimet jonizuese, për të cilin zyrtari i MMPH **Naser Balaj** arsyetoi shkaqet për çka është propozuar krijimi. Ai tha se kjo në fakt është kërkesë nga komisioni evropian, sepse rrezatimi paraqet problem global. Duke pa këtë situatë, MMPH u detyrua të propozoi në komision themelimin e autoritetit të tillë, që në shtetet e rajonit ka herë janë themeluar. Në Bruksel është raportuar nga zyrtarët e MMPH se ky agjenci do të jetë në kuadër të ministrisë dhe në nivel më të ulët se sa paraqet një departament e cila do të ketë një kryeshef, pra do të funksionoj si servil.

Lulzim Zeneli konstatoi se ky rast nuk është i ngjashëm me atë të agjencisë për pagesa, sepse këtu vjen në shprehje funksionaliteti i ministrisë në këtë fushë, e cila mund të quhet edhe ndryshe.

Hajdin Abazi tha se asnjë deputet nuk do të kundërshtonte afrimin e Kosovës me BE, por edhe këtu qëndron çështja e respektimit të ligjit, ngase bëhet fjalë për një autoritet të pavarur, ndaj duhet të qartësohet në kuadër të ministrisë apo si.

Safete Hadergjonaj konstatoi : nëse do të quhet agjenci ajo do të krijoj implikime dhe komplikime, ndaj insistoi të sjellet deklarata financiare dhe të detalizohen gjërat si duhet.

Naser Balaj sqaroi se mirëkuptimi është krijuar për të qenë kjo agjenci në kuadër të ministrisë.

Riza Smaka potencoi disa paqartësi rreth pikave të cilat sqarojnë detyrat e kësaj agjencie.

Mahir Yagcilar-ministër tha se ky problem mund të zgjidhet duke shtyre implementimin e ligjit për më vonë.

Lulzim Zeneli falënderoi pjesëmarrësit dhe përfaqësuesit e ministrive duke potencuar përkushtimin e komisionit për ti tejkaluar problemet e cekura. Ai u pajtua se duhet të krijohen bazat ligjore për veprim të mëtejshëm si në rastin e agjencisë së pagesave ashtu

edhe për agjencinë e rrezatimit, ndaj premtoi se shumë shpejt komisioni do të dalë me propozime konkrete.

Mbledhja e rregullt e komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i nenit 11.1 i projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.
3. Shqyrtimi i sugjerimeve nga takimi i përbashkët rreth dy projektligjeve në procedurë.
4. Shqyrtimi i projektligjit për produktet Biocide.

Kryesuesi Lulzim Zeneli konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i nenit 11.1 i projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes

Lulzim Zeneli përshëndeti ministrin Yagcilar të cilin e ftoi të paraqet qëndrimin politik rreth nenit 11, përkatësisht paragrafit 1 të projektligjit në fjalë, i cili parashihet të shqyrtohet në leximin e dytë në seancën e radhës.

Mahir Yagcilar kërkoi falje për mospraninë në mbledhjen e fundit të këtij komisioni për shkak të konferencës në Stamboll. Sa i përket **Nenit 11 Impiantet ekzistuese** :

- (1) Të gjitha impiantet ekzistuese duhet harmonizohen me dispozitata e këtij ligji jo më largë se 31 Dhjetor 2017.

Ai ishte i mendimit se nuk prish punë të mbetet kështu, por për të qenë fleksibil ndaj brengave të shfaqura mund të definohet apo të zëvendësohet fjalia “**jo më larg se 31 dhjetor 2017**” me fjalinë “**brenda 10 vjetësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji**”.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Neni 11.1 mbetet ashtu si është formuluar nga sponsorizuesi.

Komisioni nuk miratoi amendament ngase sipas ministrit fjala është për 10 vite të cilat janë të nevojshme apo të mjaftueshme.

3. Shqyrtimi i sugjerimeve nga takimi i përbashkët rreth dy projektligjeve në procedurë

Kjo pikë shtyhet për një ditë tjetër.

4. Shqyrtimi i projektligjit për produktet Biocide

Lulzim Zeneli tha se grupi punues e përbërë nga Elhëme Hetemi-kryesuese, Myrvete Pantina-anëtare e komisionit, Enver Tahiri-MMPH, Arbër Kepuska-MMPH rreth projektligjit

për produktet Biocide më 9.3.2009, 11.3.2009, 16.3.2009, 17.3.2009, 18.3.2009 dhe 23.3.2009 hartoi vërejtjet si vijon :

Gjatë hartimit të projektligjit Ministria ka theksuar direktivat evropiane me numra dhe data nëpër disa nene, për shkak të identifikimit më të lehtë të PB-ve në Kimikate, prandaj në rregull është të mbeten. **Këtë sugjerim e miratoi komisioni.**

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e projektligjit :

-“**aplikuesi-imi**” zëvendësohet me “**parashtruesi i kërkesës**”. Në disa raste kjo fjalë ndryshohet sipas amendamenteve veç e veç.

Amendamenti 2

Shkurtesa **PB** të qartësohet me shkronja “**produktet biocide**” të Neni 1 dhe Neni 2.

Amendamenti 3

Neni 2, par. 1, pas fjalës “...posedojnë lejen...” shtohet “**nga organi kompetent**”.

Paragrafi 4, në reshtin e dytë “**duke mos vënë në kundërshtim**” zëvendësohet me “**duke mos cenuar**”.

Amendamenti 4

Neni 3, disa përkufizime riformulohen disa përmirësohen si vijon :

Produktet Biocide (PB) nënkuptojnë preparatet kimike që përmbajnë një apo më shumë substanca aktive me qëllim të shkatërrimit, eliminimit apo parandalimit të organizmave të dëmshëm pa shkaktuar efekte të dëmshme në organizmat e tjerë ose në mjedis.

Produktet biocide me rrezikshmëri të ulët nënkupton produktet biocide të cilat përmbajnë një apo më shumë substanca aktive të cilat nën kushtet e përdorimit mund të shfaqin rrezik të ulët për njerëzit, kafshët dhe mjedisin dhe janë të paraqitura në aneksin I.

Substanca themelore – në reshtin e 3 “**kryesor**” të shkruhet “**primar**”.

Substanca aktive në produktet biocide – fjalia e fundit “**në apo kundër organizmave të dëmshëm**” riformulohet “**në organizmat e dëmshëm**”.

Substancë e dyshimtë – në reshtin e 4 fjala “**qeniet njerëzore**” bëhet “**njerëz**”, ndërsa më poshtë në reshtin e 8 “**efekt të tillë**” bëhet “**efekt të dëmshëm**”.

Organizëm i dëmshëm nënkupton çdo organizëm të gjallë prezencë e të cilit është e padëshirueshme dhe shkakton efekt të dëmshëm për njerëzit, kafshët dhe mjedisin.

Mbetjet nënkupton një apo më shumë substanca aktive të pranishme në produktet biocide, të cilat pas përdorimit të tyre mbeten të pazbërthyer duke përfshirë edhe metabolizmin e tyre ose produktet që janë si rezultat i degradimit apo i reaksionit në mes tyre.

Vendosja në treg nënkupton çdo furnizim ose ofrim për shitje në treg të produkteve biocide nga subjektet e autorizuar me këtë ligj në territorin e Republikës së Kosovës.

Autorizimi – në reshtin e 2 “**aplikantin**” bëhet “**personin që...**”.

Regjistrimi – në reshtin e 3 “**aplikanti**” bëhet “**personi**”, një resht më poshtë pas fjalës “**kërkesat**” shtohet fjala “**sipas**”, fshihet “**e**”.

Notifikim – Ky definicion mbetet deri në reshtin e 9. Pas pikës, prej fjalës “**Notifikimi**” teksti deri në fund, fshihet.

Përdorim profesional nënkupton cilin do përdorim të produkteve biocide që bëhet nga personi i autorizuar.

Titulli i përkufizimit “**shtruesi i kërkesës-aplikuesi**” zëvendësohet me “**parashtruesi i kërkesës**” e cila riformulohet :

Parashtruesi i kërkesës nënkupton prodhuesin, importuesin, distribuesin apo përfaqësuesin e tyre të autorizuar, të cilët bëjnë kërkesën me shkrim për të vendos produktin biocid në treg.

Komisioni nënkupton grupin e ekspertëve të cilët në bashkëpunim me autoritetin kompetent japin vlerësimin profesional për lëshimin e lejes për vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve biocide.

Fletëshoqëruese – në reshtin e 2 hiqet “**dhe**”.

Personat juridik persona zyrtarisht të regjistruar për të kryer ndonjë aktivitet sipas listës zyrtare të veprimtarive **ekonomike** në Republikën e Kosovës sipas ligjeve në fuqi.

EINECS (European inventory of existing komercial chemical substances) do të thotë Inventari Evropian i Substancave Ekzistuese Komerciale Kimikate e cila paraqet regjistrin e substancave ekzistuese në treg dhe i cili përmban regjistrin e të gjitha substancave në treg deri më 18 shtator 1981.

Në Përkufizime jepen sqarimet për shkurtesat **MSH** dhe **MBPZHR**.

Amendamenti 5

Neni 5, paragrafi 3 riformulohet :

Përdorimi i produkteve biocide është i lejuar deri në vlerat kufitare sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera në fuqi.

Amendamenti 6

Neni 9, në paragrafin 5, pika 5.11 riformulohet : “shënimet e tjera të nevojshme sipas ligjeve në fuqi.”

Në paragrafin 9, fjala e fundit “pëlqimin” zëvendësohet me “lejen”.

Amendamenti 7

Neni 10, paragrafi 1, në reshtin e parë, fjala “substancës” bëhet “substancave”, në reshtin e tretë pas “I.B,” fshihet “e të”.

Në reshtin e katërt pas fjalës “mjedisit” vihet pikë dhe teksti deri në fund fshihet.

Në paragrafin 4 në reshtin e parë, “e personave” bëhet “substancave aktive”.

Amendamenti 8

Neni 11, paragrafi 4, fjala “e personave” zëvendësohet me “PB-ve”.

Amendamenti 9

Neni 13, titulli përmirësohet : “Kushtet e përgjithshme për vendosjen në treg të PB-ve”.

Në paragrafin 4 fjala “mbajtësit”, në paragrafin 7 fjala “mbajtësi” zëvendësohen me fjalën “bartësi”.

Amendamenti 10

Neni 14, paragrafi 2 riformulohet :

2. Leja nga paragrafi 1 i këtij neni lëshohet-ndërpritet nga Ministri me vendim të posaçëm, kundër të cilit nuk është e lejuar ankesa. Personi ka drejt të ngritë padi në Gjykatën kompetente.

Paragrafi 6, fshihet.

Amendamenti 11

Neni 20, në paragrafin 5 në tre pikat fjala “propozim” bëhet “rekomandim”.

Paragrafi 7 riformulohet :

Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi me parashtruesit e kërkesës të cilët prodhojnë apo vendosin në treg PB.

Amendamenti 12

Neni 21, paragrafi 2, në reshtin e dytë “për vendosjen e tyre në treg” fshihet,

Paragrafi 3, në reshtin e dytë “sipas nevojës” fshihet.

Paragrafi 4, pika 4.1, “ndërmarrjes” bëhet “subjektit”.

Pika 4.7 fjala “gjendja agregate” e zëvendëson fjalën “forma”, fjalët në kllapa fshihen.

Pika 4.8 riformulohet : “klasa sipas rrezikshmërisë dhe numri i porosisë”.

Pika 4.11 , reshti dytë përmirësohet në drejtshkrim : “...vendosen në treg dhe të përdoren.”

Pika 4.12, gjithashtu përmirësohet në drejtshkrim në fund : “...ndryshimin e lejes”.

Amendamenti 13

Neni 23, paragrafi 1, pika 1.2 riformulohet : “kërkohet nga bartësi i lejes.”

Paragrafi 2, fjala “diapazonit” zëvendësohet me “fushës”.

Paragrafi 4, fshihet fjala “akoma”.

Paragrafi 5, në fund fshihet “për ndryshim”.

Paragrafi 6, në fillim “do ta” fshihet.

Pika 6.2 riformulohet : “kanë ndryshuar kushtet për dhënien e lejes”.

Pika 6.3 riformulohet : “kur kërkohet nga parashtruesi i kërkesës verifikimi gjithëpërfshirës për PB.”

Amendamenti 14

Neni 24, paragrafi 2, në reshtin e 2 “Ministria” bëhet “Ministri”, ndërsa në reshtin e 3 “propozimin” bëhet “kërkesën”.

Amendamenti 15

Neni 25, paragrafi 3, në reshtin e parë “bëhet” zëvendësohet me “nxirret”, ndërsa numri 90 zëvendësohet me 30.

Amendamenti 16

Neni 32, paragrafi 2, në reshtin e dytë fshihet fjala e përsëritur dy herë “ndërpritet”, ndërsa në vazhdim pas fjalës “ankesa” vihet pikë dhe teksti në vijim riformulohet : “Personi i pakënaqur mund të ushtroj padi në Gjykatën kompetente”.

Paragrafi 3, reshti 3, fjala “përcaktuara” bëhet “caktuara”.

Paragrafi 4, në reshtin e 4, “bërjen” zëvendësohet me “zhvillimin”.

Paragrafi 6, në reshtin e 3 “prezanton” bëhet “ofroj”.

Paragrafi 7, fjala “jepen” zëvendësohet me “ofrohen”.

Amendamenti 17

Neni 33, paragrafi 1, pika 1.1 pas “produktet në listë” teksti në vijim riformulohet :”mund të qëndrojnë në treg deri në skadimin e lejes ose përderisa qëndrimi në treg i këtij produkti të ndalohet apo kufizohet me vendim të Ministrit.”

Pika 1.2 shkurtohet si vijon : “Lista nga paragrafi 1 pika 1 do të freskohet në mënyrë të vazhdueshme duke i përfshirë notifikimet e pranuar dhe informatat shtesë.”

Pika 1.3, fshihet.

Pika 1.4, teksti në reshtin e 4 “dhe më tej (Substancat aktive në listën I, IA, IB) që” fshihet, ndërsa tekstit në vijim i shtohet “dhe” pastaj vazhdon me “...përmbajnë”.

Amendamenti 18 (Këtu komisioni ndërpreu punën)

Në titullin e Kreut V, fjala “Shenjzimi” shkruhet “Shënjimi”.

Neni 37, paragrafi 2 , pika 2.1 fshihet.

Paragrafi 4, pika 4.4, në reshtin e 2 pas fjalës “lejuar” hiqet kllapa, vihet viza lidhëse, në reshtin e 3 fshihet “për”, dhe në fund fjala “rritjes” bëhet “zhvillimit”.

Pika 4.7 riformulohet : “paketimi i PB duhet të përmbajë fletën shoqëruese me udhëzime.”

Pika 4.8 riformulohet : “udhëzimi për kujdesin e sigurt ndaj PB duhet të përmbajë fjalinë :”Lexo udhëzimin para se të përdorni PB” përfshirë edhe ambalazhin e tyre dhe aty ku është e nevojshme, duke e potencuar ndalesën për riciklimin apo ripërdorimin e tyre”.

Pika 4.10, në reshtin e 2 fshihet fjala “zhvillimin”, në reshtin e 4 pas fjalës “përdorimeve” vihet presja, në reshtin tjetër pas fjalës “produkti” fjalia “pasi të trajtohet” zëvendësohet me “i trajtuar”.

Pika 4.11 riformulohet :”specifikat për mjetet e nevojshme për dekontaminim, pastrim, masat e kujdesjes, masat për magazinim, transportim, si dhe ku mund të përdoret PB.”

Pika 4.12, fjala e parë “grupin” shkruhet “grupet”.

Paragrafi 5, në reshtin e dytë “dhe ku do të jetë e mundur pikat” fshihet.

Paragrafi 7, fshihen fjalët në kllapa pas fjalëve akaricide, rodenticide, avicidet dhe moluskicidet. Në fund fshihet edhe “26 qershor 1978”.

Amendamenti 19

Neni 59, në paragrafin 1,2 dhe 3 pas fjalës “Dënohet” fjalja “për shkelje të ligjit” zëvendësohet me fjalën “Kundërvajtje”.

Amendamenti 20

Pas nenit 61 shtohet :

Neni i ri

Pjesë përbërëse e këtij ligji janë shtojcat Një (1) deri në shtatë (7).

Amendamenti 21

Nenet në vijim përmirësohen në aspektin teknik dhe gjuhësor :

Neni 4, paragrafi 1, pika 1.6, në reshtin e 2, “për të cilat” zëvendësohet me “që”.

Neni 6, paragrafi 3, në reshtin e parë fshihet “vlerësimin”, në reshtin e 5 “dhe” bëhet “në”.

Neni 8, paragrafi 4, pika 4.2.2, në reshtin e 4, fshihet “më” dhe “larta”.

Në paragrafin 8, në reshtin e 2, pas “është” shtohet “e”.

Neni 9, paragrafi 4, pika 4.3, në reshtin e 2 “është e ditur” zëvendësohet me “ka njohuri”.

Në reshtin e njëjtë në vazhdim pas “paku” shtohet “për”.

Neni 12, paragrafi 1, në reshtin e tretë “respektivisht ndërmarrjes” fshihet.

Në paragrafin 2 në reshtin e dytë, pas “kushteve” germa “e” bëhet “të”.

Neni 15, paragrafi 2, në reshtin e dytë, “mendimin” bëhet “vlerësimin”.

Paragrafi 3, në reshtin e 5 shtohet “e” pas fjalës “mbrojtja”.

Neni 16, fjala në titull “nxjerrjen” dhe në reshtin e parë të paragrafit të parë, zëvendësohet me “marrjen”.

Në paragrafin 3.1 fshihet “ndërmarrjes apo personit”.

Në paragrafin 4 të këtij neni dhe në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 17, “aplikuesi” bëhet “personi-t”.

Neni 17, paragrafi 2, fjalët në kllapa fshihen.

Në fund të paragrafit 3 dhe 4 fjala “aplikacionit” zëvendësohet me “kërkesës”.

Në paragrafin 4 “aplikuesi” bëhet “personin” si dhe në pikën 1.2 të paragrafit 1 te neni 18.

Neni 22, paragrafi 2, në reshtin e 1 “shtrohet” bëhet “parashtrohet”.

Paragrafit 3 në fund i shtohet fjala “e lejes”.

Paragrafi 4 “Ministria” bëhet “Ministri”.

Neni 23, paragrafi 6, pika 6.1, në reshtin e 3 fshihet shkurtesa “të”.

Paragrafi 3 dhe 4 i ndërrojnë vendet.

Neni 26, fjala “Autorizimi” të shkruhet me vizë lidhëse pa kllapa.

Paragrafi 2, në reshtin e parafundit hiqet “dhe”.

Paragrafi 3, në reshtin e 7 “jenë të” të shkruhet “jetë e”. Në reshtin e fundit pas “cilësisë” shkurtesa “të” bëhet “së”.

Paragrafi 6, fjala e parafundit “prezanton” zëvendësohet me “ofron”. Po ky ndryshim vlen për paragrafin 6 të nenit 32 për fjalën “prezanton” të zëvendësohet me “ofroj”.

Neni 27, në titull shtohet vizëlidhësja pas fjalës “Regjistrimi”.

Në reshtin e 5 të paragrafit 2 “përdorimin” zëvendësohet me “përdorimit”.

Paragrafi 3, pas fjalës së parë “Dokumentacionin” shtohet “e”.

Në paragrafin 2 të nenit 28, fjala e dytë “kërkesa” zëvendësohet me “dokumentacioni”.

Neni 29, nënkapitujt d) dhe e) të shënohen me shkronja të vogla.

Paragrafi 2, pas “duhet” shtohet “të”.

Pika 2.1, fjala e parë “mbledhjen” zëvendësohet me “përmbledhjen”.

Neni 30, në paragrafin 1, pika 1.2 pas shkurtesës “për” shtohet “të”.

Pika 1.4 pas “paragrafi 1” shtohet “i”.

Paragrafi 3, fjala “periudhë kohorë” bëhet “periudhën kohore”.

Neni 31, paragrafi 1, në reshtin e parë nenet ndahen me presje. Në tekstin e mëtejme fjala “caktuar” del para fjalës “dëmsëm”.

Neni 34, paragrafi 1, në reshtin e 3 “**dhe ato që janë të vendosur në treg**” fshihet, ndërsa më poshtë “**12 muajsh**” zëvendësohet me “**një afati kohor prej një (1) viti**”.

Paragrafi 3, pika 3.1, fjalia “**e përkohshme, autorizimin ose regjistrimin**”, fshihet. Tek **neni 35** në pikën 1.3.2 në fund fshihet shkurtesa “**apo**”.

Neni 39 fshihet “**të cilat**” te pika 2.1 në reshtin e parë.

Neni 40 fshihet fjalia e fundit te paragrafi 3 pas shkurtesës PB deri në fund.

Te **kreu VI** në titull vihet presje pas fjalës “**Ndikimeve**”.

Neni 41, pika 2.5 “**dhe si**” bëhet “**si dhe**”.

Neni 42, shkurtesa MMPH të shënohet “**Ministria**”.

Neni 44, në titull mbetet vetëm fjala “**Testimi**” dhe konform këtij ndryshimi në paragrafin 1 dhe 2 fjala “**ekzaminimi**” zëvendësohet me “**testimi**”.

Paragrafi 2, fjala “**përcaktohen**” bëhet “**përcakton**”.

Neni 46, paragrafi 4, pas fjalës “**mbajtja**” shtohet “**e**”.

Pika 4.5, fshihet “**të cilat**”.

Pika 4.9, fjala “**preferuara**” zëvendësohet me “**adekuate**”.

Pika 4.13, fjala e parë “**masave**” shkruhet “**masat**”.

Neni 50, paragrafi 1, shkurtesa PB vihet pas fjalës “**Ligji**” në reshtin e parë dhe rregullohet fjalia në aspektin drejtshkrimor, ndërsa pas fjalës “**vetëm**” shtohet “**nga**”.

Neni 51, paragrafi 2, në reshtin e 4, pas fjalës “**prodhohet**” të aplikohet drejtshkrimi “**vendosen në treg apo të përdoren**”.

Neni 52, në reshtin e parë pas fjalës “**treg**” vihet presja dhe hiqet “**apo**”.

Neni 53, paragrafi 1, në reshtin e dytë aplikohet drejtshkrimi “**lëshuarjes së lejes**”.

Neni 54, **paragrafi 1** në reshtin e 4, shtohet “**nga**” pas shkurtesës “**dhe**”.

Neni 57, prej pikës 1.3 deri 1.6 para shkurtesës PB shtohet “**të**”, ndërsa në fund të pikës 1.7 shtohet “**në fuqi**”.

Neni 59, pika 1.1 në reshtin e parë pas shkurtesës PB shtohet “**i cili**”.

Pika 1.4, në fillim “**në kërkesën**” zëvendësohet me “**sipas kërkesës**”, dhe në vazhdim fjala “**prezanton**” zëvendësohet me “**ofron**”.

Pika 1.6, në reshtin e 7 fshihet “**për shënjimet**”, dhe në reshtin e 14 fshihet “**raportimin**”.

Paragrafi 3, fjala e parë “**Edhe**” fshihet.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,00, mbledhja e radhës do të mbahet të martën më 31.3.2009.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli